VENDIM
Nr.651, datë 5.8.2010

PËR LEJIMIN E KRYEMINISTRISË, SI AUTORITET KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT ME OBJEKT "ABONIMI I SHTYPIT TË BRENDSHËM", PËR NEVOJAT E VETA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Kryeministrisë, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, me objekt "Abonimi i shtypit të brendshëm", për nevojat e veta, si dhe për të lidhur kontratën përkatëse.

2. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha